



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1055/1 Prot.

Tiranë, më 29.05.2019

**VENDIM**

**Nr.51, datë 29.05.2019**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 73, DATË 20.07.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 73, datë 20.07.2018, “Mbi verifikim e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil,

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar me nr. 541 prot., datë 25.06.2018, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është vënë në dijeni, lidhur me pretendimet e kërkuësit \*\*\*\*\* , se procedimi disiplinor i filluar ndaj tij, nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 73, datë 20.07.2018, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”, të Komisionerit, në të cilin janë konstatuar shkelje në ushtrimin e funksionit publik nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të institucionit dhe

Komisionit të Disiplinës dhe janë lënë detyra konkrete për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë për këtë rast.

Konkretisht, në dispozitivin e Vendimin Nr. 73, datë 20.07.2018, Komisioneri ka vendosur:

1. *Të kërkojë nga Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, të shfuqizojë pjesërisht urdhrin nr. 207, datë 04.06.2018, në pjesën ku “\*\*\*\*\*, me detyrë në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës”, caktohet Kryetar i Komisionit Disiplinor, në cilësinë e përfaqësuesit të MIE, si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
2. *Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të marrë masa për ringritjen e Komisionit Disiplinor, në përputhje me kërkesat e Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” dhe të respektimit të procedurës së zëvendësimit të anëtarëve të KD, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, duke respektuar elementët hierarkikë që kërkohen prej akteve të mësipërme, për të siguruar raportin e niveleve administrative, ndërmjet nëpunësit të proceduar dhe proceduesit.*
3. *Komisioni Disiplinor, i ngritur për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*, për rregullimin e paligjshmërisë së procedurës disiplinore të kryejë veprimet përkatëse ligjore, për shfuqizimin e vendimit nr. 1110/2 prot., datë 18.06.2018 dhe vendimin nr. 1110/3 prot., datë 18.06.2018, si akte administrative të paligjshme dhe vetëm pas kësaj mund të fillojë shqyrtimin e procedimit disiplinor.*
4. *Komisioni Disiplinor, duhet të tregojë kujdes për respektimin e dispozitave ligjore të cilat rregullojnë institutin e ecurisë disiplinore, me qëllim garantimin e të drejtave të nëpunësit civil, nëpërmjet zhvillimit të një hetimi administrativ të bazuar në ligj dhe në prova, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Në vijim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, të nisur me shkresën nr. 703 prot., datë 07.09.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (e cila është pasuar me disa vizita në subjekt nga grupi i verifikimit, për të cilat janë mbajtur procesverbalet përkatëse, ku evidentohen sërish parregullsi në administrimin e shërbimit civil gjatë ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit), njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 13.05.2019, ka informuar grupin e

punës se kjo çështje është duke u shqyrtuar në rrugë gjyqësore (*bashkëngjitur e-mailit ndodhet kërkesa ankimore nr. 82 prot., datë 11.01.2019, e Autoritetit të Aviacionit Civil, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit kundër vendimit Nr. 4568, datë 17.12.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

Në këto kushte, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”*, konkludoj se zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 73, datë 20.07.2018, *“Mbi verifikim e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”*.
2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**